

FJALA E DEPUTETES BLERINA GJYLAMETI

E ENJTE DATA 2 MARS 2023

E nderuar zonja Kryetare,

Të nderuar kolegë,

Mendoja që seanca e sotme, së paku, duke parë edhe mungesën e pjesës më të madhe të atyre që e kërkuan, do të merrte një rrjedhë tjetër. Sot duhet të flisnim për ngjarjen makabre që ndodhi dje, duhet të flisnim për jetët e humbura të vajzave, nënave, motrave, duhet të diskutonim bashkë pse dështoi sistemi për të dënuar atë që duhet të ishte pas hekurave dhe jo i lirë, duhet të flisnim si ta bëjmë më të mirë dhe ku çdoi implementimi i ligjit, duhet të flisnim për t'u ulur përsëri bashkë në tryeza, vajza, gra, deputete, burra të këtij parlamenti, për të ashpërsuar më shumë masat përkundrejt atyre që ngrenë dorën kundrejt një nëne, një vajze, një gruaje, atyre që guxojnë të vazhdojnë të vrasin atë që sjell jetën në këtë vend. Shpresoja shumë që ata që bënë kërkesën të kërkonin jo vetëm një minutë heshtje, por edhe ndryshimin e rendit të ditës. Po ashtu, shpresoja të mos flisnim për zonat tona elektorale teksa kemi kërkuar mocion me debat për çështjen McGonigal, të mos bënim thirrje për protestën e nesërme, ndërkohë që një ngjarje kaq e rëndë ndodhi në vend. Megjithatë, gjithkush prej nesh zgjedh të thotë atë që mendon, zgjedh të bëjë atë që e mendon më të mirë, zgjedh të bëjë krenarë ata që e presin në shtëpi apo edhe të mbulohet nga turpi vetëm për pak vëmendje dhe interes politik. Gjithsesi, ajo çfarë sot ne shikojmë është thjesht më shumë ujë në një kauzë tërësisht false, që opozita tenton të ngrejë sa herë që ka një hall shumë herë më të madh sesa halli që duhet të ketë gjithsecili prej nesh në këtë foltore të nderuar. Ne sot diskutojmë me dikë që flet dhe bërtet këtu duke luftuar për demokracinë, edhe pse është shpallur non grata nga partneri ynë më i madh strategjik, por edhe nga Britania. Sot po dëgjoja me vëmendje një kolegun tim, i cili ka qenë kërkuesi dhe firmëtari kryesor për interpelancë me Kryeministrin, teksa përmendte një gazetar të shquar amerikan, Peter Lucas, prandaj do të doja t'ju sillja në vëmendje çfarë ka deklaruar dhe ka shkruar në media ky gazetar i shquar amerikan. "Në mënyrë krejt ironike, një herë e një kohë, Berisha është lavdëruar nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës për faktin se konsiderohej një reformator, i cili po sillte ndryshime mjaft të rëndësishme në një vend, i cili kishte qëndruar nën kthetrat e regjimit komunist për 40 vjet me radhë, por ky vullnet i mirë nga ana e tij nuk zgjati shumë kohë, për vetë faktin se Berisha, i cili në të shkuarën kishte qenë kirurg zemre dhe komunist, e pati të pamundur të zhdukte tiparet e autoritarit dhe të korruptuarit, të cilat shfaqen pikërisht në karakterin e çdo udhëheqësi komunist".

Nuk e di, i nderuar koleg, edhe pse nuk je në sallë, sepse duket që kauza false që ngrini çdo herë ju mjafton vetëm për të marrë disa minuta dhe më pas largoheni në atë që dini të bëni më mirë, çfarë do të thoshe tani. Ja edhe një pasazh tjetër që flet për familjen e tij, të shpallur non grata nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës për korrupsion: "Pasi ai erdhi në pushtet, abuzimet e tij ishin të panumërta. Ai dhe familjarët e tij grumbulluan pasuri marramendëse, ashtu siç kishin bërë edhe shumë ish-komunistë të tjerë në Ballkan, të cilët kishin ardhur në pushtet pas rënies së komunizmit". Të nderuar kolegë, Kur i përmendni gazetarët e njohur këtu, kur gazetaret e njohura ndërkombëtare herë i baltosni e herë i thërrisni për ndihmë me përkthimin tuaj tërësisht të pasaktë dhe sipas interesave tuaja, do të ishte mirë që të paktën t'u qëndroni atyre që thonë këtu. Megjithatë, çështja "McGonigal", për të cilën

ne jemi mbledhur sot, nuk ka asnjë lidhje me shtetin shqiptar, qeverinë apo Kryeministrin. Kjo u tha, u stërtha dhe u diskutua. Dosja hetimore ka shkuar në gjyq dhe prokuroria ka ngritur akuzë vetëm ndaj këtij ish-zyrtari të FBI-së. Nuk ka asnjë akuzë për Kryeministrin shqiptar, për qeverinë shqiptare apo për ndonjë shtetas shqiptar. Vini këtu dhe njëri bërtet për vulën, tjetri bërtet për foltoren, ziheni me njëri-tjetrin, duke u lëshuar si të dalë nga mendja kush e kush të shpikë sa më shumë, kush e kush të shthurë imagjinatën sa më shumë, sa dukeni sikur jeni ... E kam thënë edhe herë të tjera që Hiçkok-u do t'ju kishte zili për imagjinatën e shfrenuar që keni, për filmat me mafie, për mafien lokale, qendrore, ndërkombëtare, madje edhe transoqeanike dëgjova sot. Ju flisni, bërtisni, thërrisni dhe ulërin gjatë gjithë kohës për revolucionin që po troket. T'ju shikosh në sallë, jeni pak, gjatë kohës që Kryeministri foli ishit edhe më pak, t'ju shikosh në protesta, tregoni që jeni edhe më pak, kurse revolucionin juaj, që do të na trondiste, është katandisur më keq sesa kokoshi një thelë. Jeni katandisur më keq sesa kokoshi një thelë dhe ziheni midis jush kush e kush do të rrëmbejë thelën. Të nderuar kolegë, Do të ishte mirë të mos prisnit ditën e nesërme, por të uleni sot dhe ta zgjidhni këtë çështje midis jush, sepse jeni bërë gazi i botës. Një herë keni drejtues dhe lider Lulin, por më pas ju rikthehet Saliu lider legjendar, një herë shani njëri - tjetrin e më pas bëheni përsëri bashkë. Unë mendoj se do t'ju shërbente të ulet për të diskutuar dhe gjetur zgjidhje për këtë çështje, sepse në fund të ditës një opozitë e shëndoshë do të thotë një qeverisje shumë herë më e mirë. Vetëm kështu mund të kemi një përballje, sepse neve na duket kohë e humbur të përballemi me ju sot. Me kë të përballesh sot, me baltën, me llumin? Jo, nuk përballemi dot. Në fund të ditës ne e kemi me qytetarët, me punën, me ato që kemi premtuar dhe që po realizojmë, kurse nga ju sot ka vetëm ulërima dhe bërtitje.

Mendoni se do të vendosni drejtësi në Shtetet e Bashkuara? Merruni një herë me drejtësinë brenda jush, se ndoshta kjo ju çon në nivelin që duhet të ketë një opozitë. Unë dëgjoj gjatë gjithë kohës çfarë ndodh. Partia Socialiste i denoncoi rublat? Partia Socialiste deklaroi që Partia Demokratike financohej nga para ruse? Mendon ndonjë që Partia Demokratike do të merrte qoftë edhe një cent para ruse nëse Sali Berisha nuk do të ishte dakord? Kush është ky apo kjo naive që e beson këtë gjë? Stonington Strategies raportoi në Departamentin e Drejtësisë se ka marrë dy pagesa nga Partia Demokratike me vlerë totale 500 mijë dollarë dhe një pagesë të tretë nga "Binniata Trade" me vlerë 150 mijë dollarë. Kush fshihet pas kompanisë "Binniata Trade", e cila rezulton fantazmë e regjistruar në parajsat fiskale, dhe çfarë e lidh me rusët? Revista amerikane "Mother Jones" faktoi se pas pagesave të kompanisë "Binniata Trade", me bazë në Skoci, për aktivitete lobimi në favor të Partisë Demokratike përpara zgjedhjeve të vitit 2016 në Shqipëri qëndronin biznesmenë rus. Asnjëra prej këtyre pagesave nuk rezulton, meqenëse flisni gjatë gjithë kohës për transparencë, e deklaruar në raportimin financiar të dorëzuar nga Partia Demokratike në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për zgjedhjet e 25 qershorit. Kë do të bindni? E para, ju nuk keni bindur veten tuaj për sa kohë ndaheni kur thoni: "një herë ishte Luli që i pranoi, por Saliu nuk e dinte, tani Saliu e dinte, por Luli ia punoi". Kur ju nuk bindni dot njëri-tjetrin, mendoni se do të bindni ndonjë shqiptar, që nuk keni të bëni me asgjë, që paratë ruse nuk janë përdorur për të financuar fushatat tuaja? Mendoni se do të bindni ndonjë shqiptar, që nuk keni të bëni me këtë gjë, ndërkohë që raporti CIA-s ju ka renditur në klubin e të paguarve nga Rusia, bashkë me disa parti të tjera në Maqedoninë e Veriut, në Malin e zi apo në Bosnjë-Hercegovinë, që, përveçse pro ruse, janë edhe antishqiptare? Nuk e besoj. Unë besoj se arsyeja që e gjithë opozita sot është vënë në shërbim të propagandës ruse, duke sulmuar ambasadorët e Shteteve të Bashkuara dhe të Mbretërisë së Bashkuar, është ajo që ju bën bashkë. Unë besoj se ka kolegë, të cilët duhet të distancohen nga gjuha që dëgjuam sot e Putinëve të vegjël në Azi dhe në Iran. Ne sot duhet të ndahemi nga kjo gjuhë dhe të diskutojmë për shqetësimet që kanë qytetarët shqiptarë, për çfarë mund të bëjmë më mirë, por edhe për atë sistem, i cili sot tregoi që dështoi dhe se si të gjithë bashkë duhet t'i adresojmë këto problematika. Ndaj, lëreni këtë farsë, sepse nuk ju çon askund dhe ju e keni provuar që gjithmonë e më pak njerëz po ju mbështesin në revolucionin tuaj! Faleminderit!